

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram[®]-241 Flex

KOLLË PLLAKASH ME PERFORMANCË TË LARTË, FLEKSIBËL DHE ME BAZË ÇIMENTOJE, KATEGORIA C2TES1 SIPAS EN 12004

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram[®]-241 Flex është kollë pllakash e bardhë me 1 përbërës, performancë të lartë, e deformueshme dhe me bazë çimentoje, e përbërë me agregate të përzgjedhura, aditivë të posaçëm dhe polimere. Mund të përdoret për shtresa të deformueshme deri në 15mm trashësi totale. Është e përshtatshme për aplikime në mjedise të brendshme e të jashtme, mbi sipërfaqe vertikale dhe horizontale.

PËRDORIMET

SikaCeram[®]-241 Flex është e përshtatshme për ngjitjen e llojeve të mëposhtme të pllakave:

- Pllaka qeramike monocottura, bicoturra
- Pllaka të mëdha
- Pllaka mozaik
- Pllaka clinker, cotto
- Pllaka graniti artificial (përfshihen pllakat gres porcelanato)
- Mermer dhe gur natyror, vetëm nëse nuk kanë ndjeshmëri ndaj ujit

SikaCeram[®]-241 Flex mund të përdoret mbi nënshtresa të ndryshme, si:

- Llaçe betoni dhe çimentoje
- Llaçe fleksibël çimentoje
- Pllaka ekzistuese mermeri, mozaik dhe qeramik
- Tulla dhe suva
- Pllaka çimentoje dhe gipsi (me prajmerin e përshtatshëm)

SikaCeram[®]-241 Flex mund të përdoret mbi dysheme dhe mure, në zona si:

- Kuzhina, ballkone, oborre, tarraca
- Banja, kabina dushi
- Nënshtrësia me ngrohje nën dysheme
- Zona me qarkullim të theksuar

SikaCeram[®]-241 Flex është i përshtatshëm për përdorim për ngrohjen nëndysheme, mbi fasada dhe zona të jashtme, si pjesë e **Sistemit Sika të kollave të pllakave** në kombinim me llaçet fleksibël për hidroizolim dhe me bazë çimentoje Sikalastic[®] (sipas EN 14891).

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pjesë e **Sistemit Sika të kollave të pllakave** në kombinim me llaçet fleksibël dhe me bazë çimentoje Sikalastic[®]
- Shumë e deformueshme
- Tiksotropi e lartë, pa rrëshqitje vertikale
- Kohë e zgjatur punueshmërie
- Ndërkapje e shkëlqyer edhe mbi nënshtresat kërkuese
- Rezistencë ndaj ujit dhe ndikimeve të motit
- Trashësi aplikimi deri në 15 mm

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 12004-1 - Kolla për pllakat qeramike

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura, aditivë të posaçëm dhe polimere
Ambalazhi	Thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit

Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 1,60 kg/l (në +20°C)
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 0,5 mm
Deklarata e produktit	Markë CE dhe Deklaratë Performance si kollë e përmirësuar me bazë çimentoje dhe e deformueshme, me rrëshqitje të reduktuar dhe kohë të zgjatur punueshmërie, C2TES1 sipas EN 12004-1:2017, bazuar në vlerësimin e laboratorit të njoftuar dhe kontrollit të prodhimit në fabrikë.

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1,0 N/mm ² (fillestare) ≥ 1,0 N/mm ² (pas vjetrimit nga nxehtësia) ≥ 1,0 N/mm ² (pas zhytjes në ujë) ≥ 1,0 N/mm ² (pas cikleve ngrirje-shkrirje)	(EN 12004-2)
Shformimi tërthor	≥ 2,5 mm	(EN 12004-2)
Rezistenca ndaj rrëshqitjes	≤ 0,5 mm	(EN 12004-2)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	6,5 – 7,3 L ujë për thes 25 kg	
Konsumimi	Konsumimi varet nga profili i sipërfaqes dhe ashpërsia e nënshtresës si dhe gjithashtu nga përmasa e pllakave dhe teknika e shtrimit të pllakave (shtrim i thjeshtë ose lyerje me kollë edhe të pjesës së pasme të pllakës). Si udhëzim, në kilogram pluhuri për m ² :	
	Përmasat e pllakave	Madhësia e mallës
	Pllaka të vogla	6 mm
	Pllaka normale (20x20cm – 40x40cm)	8 mm
	Pllaka mesatare dhe të mëdha	10 mm
	Pllaka shumë të mëdha/ nënshtresë shumë e ashpër/ përhapja e kollës dhe në pjesën e pasme të pllakës	12-15 mm
		Konsumimi
		~2-3 kg/m ²
		~3-4 kg/m ²
		~4-5 kg/m ²
		~5-7 kg/m ²
Trashësia e shtresës	max. 15 mm	
Temperatura e mjedisit	+8°C min. / +35°C max.	
Temperatura e nënshtresës	+8°C min. / +35°C max.	
Koha e punueshmërisë	~ 3-4 orë në +23°C	
Koha e përpunimit	≥ 30 minuta (rezistenca e ndërkapjes në tërheqje ≥ 0,5 N/mm ²) (EN 12004-2)	
Koha e përshtatjeve	~ 30 min. në +23°C	
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Përpara mbushjes së fugave të pllakave mbi dysheme - qarkullim i lehtë	24 orë*
	Përpara mbushjes së fugave të pllakave mbi mur	5-12 orë*
	Përpara qarkullimit të plotë	~ 14 ditë*
	* Vlera të përfuara në kushte laboratorike: 23°C ± 2°C - Lagështi relative 50% ± 5%. Temperaturat më të larta shkurtojnë kohët e treguara, ndërsa temperaturat më të ulëta i zgjasin.	

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

SikaCeram®-241 Flex aplikohet direkt mbi nënshtresat e çimentos, suva, beton, pllakat ekzistuese, mozaik, mermer. Në kushte normale, nuk nevojitet prajmer. Megjithatë, për nënshtresa të vështira dhe/ ose absorbuese, mund të përdoren prajmerat e mëposhtëm:

Nënshtresa	Prajmer
Nënshtresa poroze (pllaka gipsi dhe çimentoje, etj.)	Sika® Primer-11 W+
Izolues i porozitetit dhe përforcues i ndërkapjes mbi nënshtresa poroze dhe joporoze	SikaTop® -10
PVC, linoleum, veshje epokside, suva gipsi, etj.	Sika® Primer-21 W
Nënshtresa metalike	Sikafloor®-156/161 (me spërkatje rëre kuarci)

Në rast nënshtresash të tjera, ju lutemi këshillohuni me departamentin teknik. Për detaje shtesë, ju lutemi referohuni në skedën teknike të prajmerit përkatës që do të përdoret.

Nënshtresa nuk duhet të ketë shtresën e kores së çimentos të betonit (qumështi), duhet të jetë e pastër, pa vaj dhe graso apo kontaminues të tjerë dhe grimca të lira ose të shkrifëta.

Nënshtresa duhet të jetë e niveluar në mënyrë të përkryer, e qëndrueshme dhe në moshën e duhur. Çdo pjerrësi apo gungë e vogël mund të nivelohet dhe mbushet me një shtresë SikaCeram®-241 Flex në trashësi max. 5 mm, të aplikuar të paktën 24 orë përpara shtrimit të pllakave qeramike. Për trashësi më të madhe, mund të përdoren llaçe të prodhuar në kantier të përgatitur me SikaLatex® Max ose Sika ViscoBond® ose llaçe për riparime nga seria Sika® MonoTop ose SikaRep®. Në rast kërkesash për nivelim nënshtrese, rekomandohet përdorimi i produkteve Sika® Level (llaçe të vetënivelueshëm çimentoje për dyshemetë).

PËRZIERJA

Përzieri thesin 25 kg me sasinë e nevojshme që përmendet më sipër të ujit me një mikser elektrik me spirale në shpejtësi të ulët (max. 500 rpm, për të parandaluar bllokim e ajrit në miks), në një kovë të pastër derisa të përftohet një pastë e lëmuar dhe pa kokrriza. Pas përzierjes, lëreni produktin të qëndrojë për 5 min. dhe pastaj përzieni sërish përpara aplikimit. Miksi i përfutur duhet të jetë shumë kremoz, lehtësisht i përhapshëm dhe shumë tiksotropik.

APLIKIMI

SikaCeram®-241 Flex aplikohet me mallë krëhër. Sasia e produktit duhet të jetë e mjaftueshme për të siguruar edhe mbulimin e pjesës së pasme të pllakës. Shtrimi i pllakave duhet bërë ndërsa kolla është ende e freskët, duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontakt të plotë me kollën dhe kështu të arrihet ngjitje e përkryer. Në rast se mbi sipërfaqen e kollës formohet një cipë, kaloni edhe një herë përsipër

mallën. Shmangni lagjen me ujë të kollës së aplikuar, pasi kjo gjë mund të dëmtojë procesin e ngjitjes. Zgjidhni madhësinë e përshtatshme të mallës që do të përhapë trashësinë e duhur të kollës në pjesën e pasme të pllakës.

SikaCeram®-241 Flex mund të përdoret për fiksimin e pllakave me absorbueshmëri të ulët me madhësi maksimale:

Madhësia	Përdorimi
Deri në 10.000 cm ² (p.sh. 100cmx100cm)	Nënshtresa dyshemeje të brendshme
Deri në 3.600 cm ² (p.sh. 60cmx60cm)	Nënshtresa dyshemeje të jashtme
Deri në 2.100 cm ² (p.sh. 30cmx60cm)	Nënshtresa muri të brendshëm e të jashtëm

Për shtrimin e pllakave prej sipërfaqeje totale 900 cm² dhe më shumë (p.sh. 30x30 cm), rekomandohet gjithnjë teknika e përhapjes së kollës mbi nënshtresë por edhe në pjesën e pasme të pllakës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të kryhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nënshtresat prej suvaje gipsi duhet të kenë trashësi minimale 10 mm dhe përmbajtje max. lagështie 0.5%.
- Nëse kërkohet shtresë hidroizoluese poshtë pllakave, mund të përdoren produktet e mëposhtme: SikaTop® Seal-107 FL-X, Sikalastic®-152, Sikalastic®-1K, Sika® SealTape-S.
- Për aplikimet kërkuese (p.sh. sipërfaqet e jashtme) përdorni poshtë kollës një produkt sipas EN 14891 (p.sh. Sikalastic®-1K class CMO1P)
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrica dhe shiu.
- Aplikoni kollën mbi një zonë për testim përpara nisjes së punimeve me pllakat prej guri natyror.
- Nuk është e nevojshme të lagen paraprakisht pllakat.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram®-241 Flex

Gusht 2019, Botimi 03.01

020404020010000422

SikaCeram-241Flex-sq-AL-(08-2019)-3-1.pdf